



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Data: 27.04.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Punime mirëmbajtje në “Sporti i Vogël ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punime ndertimi 45210000-2

VLERA E FONDIT LIMIT:

2,438,534 *(dy milion e katerqind e tridhete e tete mije e peseqind e tridhjet e kater) lekë, PA TVSH.*

Ky objekt eshte parashikuar te financohet nga të ardhurat e Bashkisë Korçë + Financim nga Trans Adriatic Pipeline AG

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **BASHKIA KORÇË** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023,2024,2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në **ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat**, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".*

*AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje **Nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat"**: 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.*

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më e vogël se 30 %** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se** vlera limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :

1. Formularin e vleresimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore te deklaruar në organet tatimore

-Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomikë.

-Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55 pika 4 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, **autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë** burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe **përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Lidhur me dokumentacionin e kërkuar për vërtetimin e punëve të ngjashme janë kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se: **Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të**

kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.

Ne kuader te vleresimit te ofertave ne menyre sa me te drejte, duhet qe ne rastet e BOE apo Nenkontraktimit, vleresimi i përvojës të mëparshme të vërtetohet me paraqitjen e kontrates se bashkepunimit apo marreveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit te nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Dokumenta keto te nevojshme per te vleresuar lidhur me punet konkrete qe ka kryer OE si anetar i BOE, apo si nënkontraktor. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta kete çdo kompani në dosjen e saj, per rrjedhoje nuk mund te sjelle kufizim te pjesmarrjes se OE ne tender as ne menyre direkte dhe as ne menyre indirekte.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore të sipërcituar dhe vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qellim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.2.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Licenca duhet te permbajë kategoritë e punimeve të kontratës si me poshtë:

PER PUNIMET E PERGJITHSHME TE NDERTIMIT

Kategoria Klasifikimi Emertimi i kategorise

N.P – 1 A Punime gërmimi në tokë.

N.P - 3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.

PËR PUNIMET SPECIALE TË NDËRTIMIT:

Kategoria Klasifikimi Emertimi i kategorise

N.S – 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në Nr. 42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

| Kategoria e kërkuar | Pershkrim i kategorisë sipas legjislacionit të fushës | Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse | Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive | Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse |
|----------------------------|--|---|--|---|
| N.P-1 | Punime gjurmimi në tokë | Gjurmim dheu me krah e transport k dore 10m,kat III Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km | A, 0-20 milionë lekë | 7,694.15 lekë |

| | | | | |
|--------------|--|---|----------------------|-------------------|
| N.P-3 | Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje e godinash civile e industriale, veshje fasada. | Shtrese betoni C 16/20 Dritare d/alumini dyfi xh. Dyer d/alumini me mbushje element d/a. Shtrese me pllaka grez porcelanato Pllaka te vogla mermeri 2 cm Suvatim me llaç-çimento Veshje muri me polisterol te thjeshte t=5cm rrjete+suva. Boje hidroplastike cilesi e larte Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka Tapet bari artificial me ngjyre jeshile, material polietileni, kategoria multisport me gjatesi te fijos 25 mm, dendesi 21000 tufa per m ² dhe dtex 9000. Me pjesen e poshtme, te perbere dy shtresa: PP+Net dhe latex. (800 m ²) F.V Zgarë Metalike për kunetë F.V Tabelë Basketbolli+Kosh metalik+aksesorë F.V Stola plastikë F.V Rrjetë Volejboli Komplet | A, 0-20 milionë lekë | 2,284,973.43 lekë |
| N.S-1 | Punime për prishjen e ndërtimeve | Heqje pllaka dyshemeje Heqje pllaka trotuari Heqje shtresë tartani për 1 m ² | A, 0-20 milionë lekë | 44,121.85 lekë |

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.2.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës e vlefshme

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d",

“dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj”, VKM Nr 42 date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, Udhezimit Nr 2 date 13.05.2021 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”,i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin kryesor të nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të zberthimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Konkretisht:

Kerkesa per drejtuesin teknik “**Inxhinier Ndertimi**”. Eshte vendosur duke u bazuar ne ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar,pasi per cdo objekt zbatimi duhet te kete drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij ne perputhje me kete ligj dhe vendimin Nr.312, datë 5.5.2010”Për miratimin e rregullores “për sigurinë në kantier,Udhezimit Nr 2 date 13.05.2021 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”,i ndryshuar.

Bazuar ne zerat e punimeve te parashikuara ne preventiv nevojitet nje drejtues teknik me profesion **ing.ndertimi** i cili do te jete përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me projektin, preventivin, specifikimet teknike, standardet dhe grafikun e miratuar, deri në kolaudimin e objektit.

ARGUMENTIMI STAFI DREJTUES

Punimet apo veprimtarite konkrete per te cilat kerkohet ekspertiza e tyre profesionale jane:

| | |
|--------------------|--|
| Inxhinier Ndërtimi | Germim dheu me krah e transport k dore 10m,kat III Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km Shtrese betoni C 16/20 Dritare d/alumini dyfi xh. Dyer d/alumini me mbushje element d/a. Shtrese me pllaka grez porcelanato Pllaka te vogla mermeri 2 cm Suvatim me llaç-çimento Veshje muri me polisterol te thjeshte t=5cm rrjete+suva. Boje hidroplastike cilesi e larte |
|--------------------|--|

| | |
|--|--|
| | Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka Tapet bari artificial me ngjyre jeshile, material polietileni, kategoria multisport me gjatesi te fijes 25 mm, dendesi 21000 tufa per m ² dhe dtex 9000. Me pjesen e poshtme, te perbere dy shtresa: PP+Net dhe latex. (800 m ²) F.V Zgarë Metalike për kunetë F.V Tabelë Basketbolli+Kosh metalik+aksesorë F.V Stola plastikë F.V Rrjetë Volejboli Komplet Heqje pllaka dyshemeje Heqje pllaka trotuari Heqje shtresë tartani për 1 m ² |
|--|--|

2.2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **9 persona**, dokumentuar kjo me vertetimin e pageses se sigurimeve shoqerore dhe shendetesore nga administrata tatimore dhe listpagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

| Lloji i Makinerive | Sasia | Pronesia |
|-------------------------------|--------------|------------------------|
| Mjet transporti deri në 5 ton | Cope 1 | ne pronesi ose me qira |

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike duhet te paraqiten dokumentat si më poshtë :

-Ne rast se mjeti eshte ne pronesi te paraqiten: certifikata e pronesise, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit dhe çertifikatë për transport mallrash brenda vendit per mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg.

-Ne rast se mjeti eshte me qera te paraqiten: kontrata e qerese e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit, certifikaten e pronesise, certifikaten e

kontrollit teknik, siguracionin e mjetit dhe çertifikatë për transport mallrash brenda vendit, për mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg.

(Ne rastin e mjeteve të marra me qira nga operatorët ekonomikë bazuar në njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022, referuar dokumentacionit (leje qarkullimi, çertifikate e transportit të mallrave), mjetet nuk duhet të rezultojnë për përdorim vetjak por për përdorim nga të tretet)

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".

Argumentimi i kriterëve 2.2.4 dhe 2.2.5: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç ku përcaktohet se "Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit" dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ku përcaktohet se „Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.“

Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin minimal të punonjësve dhe të mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, është zbatuar legjislacioni i fushës, konkretisht VKM Nr. 216, datë 13.4.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit" dhe gjithashtu jam bazuar edhe në rekomandimin e APP Nr 1797/1 datë 10.03.2022 janë parashikuar orët e punës për secilin zë punimesh sipas tabelës bashkelidhur dhe bazuar edhe në afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve është përcaktuar numri minimal i punonjësve të domosdoshëm për realizimin e punimeve.

Numri i fuqisë punëtore është llogaritur në baze të zberthimit të grafikut të punimeve, zberthimit të preventivit dhe natyrës së objektit, numri prej 9 personash përfshin personelin kryesor drejtues teknik dhe punëtorë të tjere përllogaritur nga zberthimi i preventivit, grafikut të punimeve dhe natyrës së objektit.

Konkretisht nga llogaritjet e bera nga specialisti i fushes rezulton se :

Sasia totale e oreve te punes sipas manualit dhe analizave teknike për cdo zë të preventivit është **1293.61** ore. Llogaritja e numrit te punonjesve ne varesi te oreve te punes dhe afatit te kontrates eshte si me poshte:

| | |
|--|----------------|
| <i>Totali orë pune + orë makineri</i> | 1293.61 |
| <i>Ditë pune (orë pune/8)</i> | 161.7 |
| <i>Specialiste+punetore per 1 muaj</i> | 8 |
| <i>Ing. ndërtimi</i> | 1 |
| <i>Numri i punëtorëve gjithsej</i> | 9 |

Argumentim: Lidhur me mjetet edhe pajisjet teknike:

Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter u vendos duke patur parasysh natyrën dhe volumin e punimeve të parashikuara në preventiv.

Gjithashtu bazuar në nenin 28 të Udhezimit Nr.15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” i ndryshuar, “Kamionët me kapacitet transportues nën 1500 kg nuk certifikohen për transport mallrash brenda vendit.”

| Lloji i Makinerive | Sasia | Pronesia | Argumentimi |
|-------------------------------|--------------|------------------------|---|
| Mjet transporti deri në 5 ton | cope 1 | ne pronesi ose me qera | Nevojitet për transportin e materialeve të ndërtimit, dheut me auto |

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s’kualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Dokumentacioni teknik ku përfshihen Specifikimet Teknike, Projekti, Preventivi dhe Grafiku i Punimeve për këtë objekt janë dorëzuar nga **Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës**, pjesë perberese e strukture së Bashkisë Korçë, në përputhje me detyrat e saj funksionale.

Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b, dhe nenit 36 të LPP (e ndryshuar), si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit” i ndryshuar.

Në çdo rast nëse janë përmendur marka prodhimi, burim specifik apo proces i veçantë do të pranohen edhe ekuivalenti i tij/saj.

Gjate hartimit të specifikimeve teknike janë marrë në konsideratë kërkesat ligjore të fushës së planifikimit dhe zhvillimit të territorit si dhe normat perkatëse të përcaktuara në aktet në ligjore në fuqi në fushën e ndërtimit.

Specifikimet teknike janë sipas materialit i cili është publikuar së bashku me dokumentat e tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT